



“WIPROTECTION” SHPK
NIPT M11609007T

K Ë R K E S Ë

P Ë R **NJË SHITESË NË OBJEKTIN E AKTIVITETIT TË SHOQËRISË**

KËRKUES: **Ndriçim Ibro**, Administrator i Shoqërisë “WIPROTECTION” shpk me qendër në Tiranë, me adresë Rruga Kombëtare Tiranë-Elbasan, Komuna Kërrabë, Fshati Mushqeta, Zona Kadastrale 2752, Nr. 110/3, me datë regjistrimi 09.04.2021, me numër NIPT-i M11609007T

OBJEKTI: Kërkohet shtesë në objektin e aktivitetit të shoqërisë

BAZA LIGJORE: - Neni 95/3 i Ligjit nr. Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”
- Nenet 32 e 43 të Ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”
- Nenet 14 e 15 të Statutit të Shoqërisë “WIPROTECTION” shpk

D R E J T U A R: **Qendrës Kombëtare të Biznesit**

Adresa: Bulevardi Zhan D'Ark, Tiranë 1010

T i r a n ë

Të nderuar,

Shoqëria “WIPROTECTION” shpk është themeluar më datë 08.04.2021 dhe është regjistruar në QKB më datë 09.04.2021, me numër NIPT-i M11609007T.

Shoqëria ka zyrën Qendrore në Tiranë në adresën Rruga Kombëtare Tiranë-Elbasan, Komuna Kërrabë, Fshati Mushqeta, Zona Kadastrale 2752, Nr. 110/3.

Me cilësinë e Administratorit të Shoqërisë,

Në mbështetje të:

- Neni 95/3 i Ligjit nr. Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

Rruga Kombëtare Tiranë-Elbasan, Komuna Kërrabë, Fshati Mushqeta
Zona Kadastrale 2752, Nr. 110/3, Tiranë

- Neneve 32 e 43 të Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"
- Neneve 14 e 15 të Statutit të Shoqërisë "WIPROTECTION" shpk

Kam vendosur të bëj një shtesë në objektin e aktivitetit të shoqërisë.

Sa më sipër,

K Ë R K O J:

Që, në Statutin e Shoqërisë "WIPROTECTION" shpk, në Nenin 2 "Objekti", në Pikën 2.1, ku përcaktohet se Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm, pas gërmës "q" të shtohet gërma "r", me këtë përmbajtje:

"r. transferimin ndërkombëtar të mallrave, të cilat mund të konsiderohen si mallra me përdorim të dyfishtë, përfshirë shërbimet e ndërmjetësimit, prodhimit, shkencës, bashkëpunimit teknik, demonstrimet e tyre në ekspozitat e panairit ndërkombëtar për qëllime reklamimi, testimi, marketingu dhe veprime të lidhura me to deri në përdorimin përfundimtar apo përdoruesin e fundit".

Kopje e kësaj kërkesë të depozitohet sipas rregullave në Qendrën Kombëtare të Biznesit për të kryer veprimet përkatëse.

Faleminderit,

PËR SHOQËRINË "WIPROTECTION" shpk
ADMINISTRATORI

Tiranë, më 04.05.2021

Ndriçim Ibro

Ndriçim Ibro
